

RAPORT

mbi aktivitetet e
OJQ-ve në Mal të Zi
në vitin 2024.

BOTUES:
Qendra për Zhvillimin e Organizatave
Joqeveritare (CRNVO)
rr. Sima Barovića 24, Podgoricë
Tel/fax: 020/219 120, 219 121, 219 122, 219 123
E-mail: crnvo@crnvo.me www.crnvo.me

Titulli i publikimit:
HULUMTIM PËR PJESËMARRJEN E OJQ-ve
NË HARTIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE
NË v. 2024

PËR BOTUESIN:
Zorana Marković

AUTORËT:
Filip Vicković
Nazif Veliq
Zdravko Janjušević
Marina Vuksanović
Milan Medenica
Kenan Keçević
Zorana Marković

BASHKËPUNTORËT NË HULUMTIM:
Milosh Marković
Aleksa Miniq
Hazreta Cuca

PËRGATITJA dhe DIZAJNI
New Page D.O.O.
Podgoricë, korrik 2025.

**Raporti u përgatit në kuadër të projektit “Rrjeti i qendrave burmiore të Malit të Zi”.
Pikpamjet dhe përfundimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht
qëndrimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe bashkëpunimit me
organizatat joqeveritare.**

HYRJE

Në shoqëritë moderne, organizatat joqeveritare njihen si një segment i rëndësishëm i shoqërive bashkëkohore demokratike dhe pranohen si aktorë të rëndësishëm në përmirësimin e politikave publike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve me interes publik. Rëndësia e aktiviteteve të realizuara nga OJQ-të pasqyrohet edhe në aftësinë e tyre për të mobilizuar komunitetet, për të artikuluar nevojat e qytetarëve dhe për të promovuar politika publike të bazuara në parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Aktivitetet e organizatave joqeveritare në Mal të Zi përfshijnë një gamë të gjerë iniciativash që kontribuojnë në forcimin e vlerave demokratike, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, zhvillimin shoqëror dhe ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Veprimtaria e tyre në fushat e arsimit, mbrojtjes sociale, punës humanitare, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm kontribuon jo vetëm në përmirësimin e drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës, por edhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të shoqërisë.

Një nga fushat kryesore të veprimtarisë së organizatave joqeveritare është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe advokimi për politika publike. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, organizatat monitorojnë zbatimin e ligjeve dhe politikave publike, identifikojnë parregullsitë, ofrojnë mbështetje për qytetarët dhe u drejtojnë rekomandime institucioneve kompetente për përmirësimin e kuadrit normativ dhe institucional.

Një segment i veçantë i punës lidhet me aktivitetet arsimore dhe zhvillimore, përfshirë organizimin e trajnimeve, punëtorive dhe programeve të arsimit joformal. Këto aktivitete kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve të individëve dhe grupeve, rritjen e nivelit të informimit dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset shoqërore.

Organizatat joqeveritare gjithashtu realizojnë programe në fushën e mbrojtjes sociale dhe veprimtarisë humanitare, duke ofruar mbështetje për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara. Aktivitetet në këtë fushë përfshijnë ofrimin e shërbimeve sociale, mbështetjes psikosociale, si dhe realizimin e projekteve të orientuara drejt përfshirjes sociale.

Për më tepër, një numër i konsiderueshëm organizatash vepron në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes, promovimit të menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve natyrore dhe zbatimit të iniciativave lokale ekologjike. Përmes këtyre aktiviteteve, organizatat joqeveritare kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë dhe forcimin e qëndrueshmërisë së komunitetit.

Monitorimi dhe analiza e këtyre aktiviteteve janë me rëndësi thelbësore për kuptimin e kontributit real të sektorit civil. Një pasqyrë e strukturuar mirë mbi numrin dhe llojin e aktiviteteve që realizojnë OJQ-të mundëson afirmimin e punës së tyre, forcimin e besimit të publikut dhe krijimin e politikave publike që u përgjigjen nevojave reale të komunitetit.

Pikërisht për këtë arsye, me qëllim të sigurimit të një pasqyre më të mirë mbi llojin dhe numrin e aktiviteteve të realizuara nga organizatat joqeveritare në Mal të Zi gjatë vitit 2024, është zhvilluar një hulumtim i bazuar në kombinimin e pyetësorëve, analizës së raporteve publike të disponueshme dhe intervistave me përfaqësues të organizatave. Të dhënat janë mbledhur në kuadër të programit "Rrjeti i qendrave të burimeve në Mal të Zi", i cili, me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Investimeve dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, realizohet nga Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare si qendër kombëtare e burimeve, qendrat rajonale të burimeve të OJQ-ve: Qendra Demokratike e Bjellopojës, OJQ Zona Aktive dhe OJQ Horizonte të Reja, si dhe zyrat lokale të OJQ-ve Bonum, Natura dhe Nada.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të numrit dhe llojit të aktiviteteve që organizatat joqeveritare (OJQ) në Mal të Zi kanë organizuar dhe realizuar gjatë vitit 2024. Qëllimi i tij është të paraqesë në mënyrë sistematike dhe transparente kontributin e sektorit civil në zhvillimin e shoqërisë, përmes iniciativave që përfshijnë fusha të ndryshme tematike – nga mbrojtja e mjedisit dhe të drejtave të njeriut, përmes arsimit dhe kulturës, deri te përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal.

Në çfarë mënyre monitorohen **aktivitetet e OJQ-ve?**


Duke pasur parasysh se në Mal të Zi janë të regjistruara mbi 7000 organizata joqeveritare, ndjekja e aktiviteteve të të gjithë sektorit paraqet një sfidë. E vetmja mënyrë e organizuar për mbledhjen e informacioneve mbi aktivitetet e zbatuara do të mund të bazohet në raportet për realizimin e projekteve të financuara nga fondet publike, të cilat do të dorëzoheshin në format të hapur, sipas shembullit të sistemeve më moderne, ku indikatorët e realizimit të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura futen në format të hapur, duke mundësuar përpunimin e përmbledhur të të dhënave.

Mënyra e dytë është përmes monitorimit të raportimit në media, megjithatë kjo metodë nuk është e përshtatshme për shkak se nuk publikohen dhe promovohen të gjitha aktivitetet e realizuara nga OJQ-të, ndërsa ato që promovohen nuk promovohen me të njëjtin intensitet. Mënyra e tretë, e cila është përdorur gjatë përgatitjes së këtij raporti, është mbledhja e informacioneve drejtpërdrejt nga organizatat përmes pyetësorit. Në këtë mënyrë është e mundur të përcaktohen një sërë pyetjesh të orientuara drejt mbledhjes së informacioneve relevante për krijimin e një baze fillestare dhe hartimin e politikave publike që do t'u përgjigjen nevojave reale të OJQ-ve.

Rezultati i pyetësorit: **Çfarë lloj aktivitetezh zhvillojnë OJQ-të?**

Pyetësori për organizatat joqeveritare është realizuar me qëllim të mbledhjes së informacioneve më të detajuara mbi masën e angazhimit të OJQ-ve në Mal të Zi, numrin e aktiviteteve që ato zhvillojnë dhe llojin e këtyre aktiviteteve. Përmes pyetjeve të hollësishme, pjesëmarrësit në anketë mund të ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme mbi punën e shoqërisë civile, fokusin e tyre dhe boshllëqet e mundshme në fushat me interes publik.

Informacionet e mbledhura përmes pyetësorit janë veçanërisht të rëndësishme, duke pasur parasysh se nuk ekziston një mënyrë e sistematizuar dhe gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetet e organizatave joqeveritare, pavarësisht nga burimi i financimit, fusha e veprimtarisë dhe lloji i aktivitetit.



Në pyetësin e shpërndarë për organizatat joqeveritare në Mal të Zi janë përgjigjur 107 përfaqësues të OJQ-ve. Në pyetjen: "A keni organizuar ndonjë aksion ose aktivitet gjatë vitit 2024 dhe cili është numri i tyre?", vetëm 15% nuk kanë organizuar asnjë aktivitet, 26% kanë organizuar nga një deri në tre aktivitete, 16% kanë organizuar nga 4 deri në 6 aktivitete, 23% e organizatave kanë realizuar nga 7 deri në 10 aktivitete, ndërsa 19% e organizatave kanë realizuar më shumë se 10 aktivitete.

Ndër llojet e aktiviteteve, më e përhapura ndër organizatat joqeveritare është organizimi i punëtorive edukative dhe trajnimeve, të cilin e kanë praktikuar 67.4% e organizatave që kanë marrë pjesë në pyetësor. Fushata publike dhe aktivitete advokuese kanë realizuar 42.1% e organizatave, ndërsa aksione vullnetare në komunitet kanë zhvilluar 38.9% e OJQ-ve.


Me aktivitete kërkimore janë marrë 35.8% e organizatave, ndërsa me aksione humanitare 25.3%. Me manifestime kulturore dhe aksione ekologjike janë marrë 30.5% e organizatave.

Ndër aktivitetet më pak të përfaqësuara (me rreth 1%) janë: aktivitetet online (menaxhimi i blogjeve online), shërbimet psikosociale, organizimi i aktiviteteve dhe manifestimeve sportive, panairëve, parlamentit rinor, diskutimeve në panele, kurseve të gjuhëve, ndarja e granteve, shërbimet e këshillimit dhe linjat telefonike SOS.



Gjetjet e pyetësorit tregojnë se OJQ-të kryes lokale. 73.9% e organizatave kanë zhvilluar aktivitetet në nivel lokal (verior, qendror ose jugor), 34.8% në nivel kombëtar, ndërsa 22.8% edhe në nivel ndërkombëtar.

Në çfarë niveli i keni zhvilluar aktivitetet gjatë vitit 2024?




Sa i përket grupeve të synuara, numri më i madh i organizatave ka punuar me fëmijët dhe të rinjtë: 68.9% e organizatave. Aktivitete të drejtuara ndaj organizatave të tjera joqeveritare kanë zhvilluar 52.2% e organizatave. Aktivitetet e dedikuara grave si grup specifik i synuar janë realizuar nga 42.2% e organizatave. Ndaj vendimmarrësve i kanë orientuar aktivitetet e tyre 33.3% e organizatave. Mediat dhe gazetarët kanë qenë grup i synuar për 31.1% të organizatave. Personat me aftësi të kufizuara kanë qenë grup i synuar për 27.8% të pjesëmarrësve në anketë.

Me aktivitete të drejtuara ndaj personave të papunë janë marrë 20% e organizatave, ndërsa ndaj popullsisë së moshuar 11.1%. Komuniteti i biznesit ka qenë grup i synuar për 8.9% të organizatave.

Ndër grupet më pak të përfaqësuara si grupe të synuara të OJQ-ve (me rreth 1%) janë këto: organizatat joqeveritare të huaja dhe rajonale, komuniteti LGBT, publiku ndërkombëtar profesional në fushën e trashëgimisë kulturore, turistët, romët dhe egjiptianët, si dhe punonjësit e institucioneve.

Drejt cilave grupe të synuara ishin orientuar aktivitetet?



PËRFUNDIME & REKOMANDIME

Organizatat joqeveritare zhvillojnë një gamë të gjerë aktiviteteve në baza të përditshme. Ndër to ka aktivitete që ndiqen dhe promovohen publikisht përmes rrjeteve sociale, por edhe disa të tjera që, për arsye sigurie dhe privatësie, nuk mund të publikohen në mënyrë eksplicite, siç është mbështetja për viktimat e dhunës. Disa nga aktivitetet financohen nga donatorë të ndryshëm (Qeveria e Malit të Zi, vetëqeverisjet lokale, Bashkimi Evropian dhe të tjerë), ndërsa disa aktivitete të tjera zhvillohen pa mjete të siguruara financiare dhe plotësisht në baza vullnetare. Për këtë arsye, një grup kaq i larmishëm aktiviteteve është i vështirë të ndiqet dhe të hartëzohet në mënyrë sistematike dhe të plotë.

Për ta lehtësuar këtë detyrë, është e nevojshme të mbahet një evidencë e integruar në sistemin e raportimit në format të hapur, në nivel të të gjitha organeve të administratës në nivel shtetëror dhe lokal që shpërndajnë mjete për organizatat joqeveritare. Kjo evidencë duhet të përmbajë të dhëna mbi numrin dhe llojin e aktiviteteve të realizuara, numrin e anëtarëve të grupit të synuar të përfshirë, rezultatet e projekteve dhe të dhëna të ngjashme. Mbi bazën e këtyre të dhënave do të krijoheshin grupe të dhënash (data sets), të cilat do ta lehtësonin ndjekjen e trendeve të zhvillimit të shoqërisë civile në Mal të Zi, financimit të disponueshëm dhe kontributit të organizatave joqeveritare në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të Malit të Zi.

Nëse ekzistojnë të dhëna se cilat organizata janë aktive në fusha të caktuara dhe çfarë lloji aktiviteteve zbatojnë, atëherë është më e lehtë të identifikohen “boshllëqet” në praktikë. Për shembull, përmes të dhënave të hapura mund të arrijmë në përfundimin se asnjë organizatë nuk merret me edukimin e të rinjve për planifikimin hapësor dhe se nuk është zhvilluar asnjë trajnim për këtë temë për ta. Në këtë mënyrë, do të identifikonim mungesën e përmbajtjeve dhe aktiviteteve të rëndësishme që duhet të mbështeten në të ardhmen.

Gjithashtu, të dhënat e hapura në këtë aspekt mund t’u ndihmojnë organizatave joqeveritare që të bashkohen më lehtë, duke identifikuar më shpejt organizatat e ngjashme dhe të afërta me fushën e tyre të veprimtarisë, duke krijuar kështu një komunitet praktikash (community of practice) për fushat përkatëse. Për shembull, të gjitha organizatat që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna do të mund të bashkohen dhe të advokojnë së bashku për përmirësimin e legjislacionit në fushën e tyre të punës.

Disponueshmëria e të dhënave mbi llojin dhe numrin e aktiviteteve të OJQ-ve do të ishte gjithashtu e rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve të vetë organizatave joqeveritare për zbatimin e aktiviteteve të ardhshme. Për shembull, nëse kërkojmë në një bazë të dhënash dhe gjejmë organizatat që janë marrë me kërkime, analiza dhe punime të ngjashme, si dhe shqyrtojmë rezultatet e punës së tyre, mund të përcaktojmë nëse cilësia e punës së tyre është në nivelin e duhur dhe të planifikojmë në mënyrë adekuate ngritjen e kapaciteteve në fushat ku është evidentuar mungesa.

Në fund, njohja adekuate e kontributit të organizatave joqeveritare në shoqërinë malazeze përmes aktiviteteve të tyre do të ndikonte në krijimin e një imazhi më pozitiv të shoqërisë civile si një faktor kyç dhe konstruktiv i komunitetit dhe si nxitës i reformave demokratike dhe progresive. Kjo do të ndihmonte në zvogëlimin e perceptimeve negative ndaj OJQ-ve, të cilat kohët e fundit janë bërë të përhapura në mbarë botën, së bashku me iniciativat për etiketimin e OJQ-ve si “agjentë të huaj”

RRETH PROGRAMIT

Programi "Rrjeti i Qendrave të Burimeve të Malit të Zi" zbatohet me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe Bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të organizatave joqeveritare dhe përmirësimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Mal të Zi.

Programi realizohet përmes Qendrës Kombëtare të Burimeve, të udhëhequr nga Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO), si dhe rrjetit të tre qendrave rajonale të burimeve dhe tre zyrave lokale.

Qendrat rajonale të burimeve janë:

- Qendra Demokratike e Bijello Poles – për rajonin verior;
- Horizonti i Ri (Ulqin) – për rajonin jugor;
- Zona Aktive (Nikshiq) – për rajonin qendror.

Zyrat lokale funksionojnë në:

- OJQ Bonum – Plav;
- OJQ Natura – Kotor;
- OJQ Nada – Herceg Novi.

Qëllimi i programit është të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për organizatat joqeveritare, grupet joformale të qytetarëve dhe institucionet publike, përmes:

- ofrimit të informacionit dhe këshillimit;
- asistencës juridike dhe teknike;
- ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe mentorimit;
- mbështetjes në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve;
- promovimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes;
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
- nxitjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë.

Përmes rrjetit të qendrave të burimeve, organizatat joqeveritare në të gjitha rajonet e Malit të Zi kanë qasje në shërbime profesionale, mbështetje për zhvillimin organizativ dhe mundësi për përfshirje më aktive në proceset e hartimit të politikave publike dhe zhvillimit të komuniteteve lokale.

KE NDONJË PYETJE?



+ 382 20 219 860



crnvo@crnvo.me



<https://crnvo.me/>

